

## SEANCA E KUVENDIT TË KOSOVËS

E mbajtur më datën 10.12.2001

**Z. HANS HAKERUP**, përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kuvendi u konstitua. Kjo është një ditë historike për Kosovën, për herë të parë në histori tani po marrim pjesë në hapjen e këtij Kuvendi, të zgjedhur vërtet në mënyrë demokratike që perfaqëson popullin e Kosovës. Kjo ditë gjithashtu paraqet edhe një gurthemel të rëndësishëm në sendertimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Sot jemi dëshmitar të vendosjes së vetëqeverisjes përmbajtësore e kuptimplotë në Kosovë. Ju të nderuar deputet të Kuvendit tani po merrni mbivete një detyrë të rëndësishme dhe që kërkon shumë detyra për të marrë vendime që do të kenë ndikim në jetën e çdo qytetari të Kosovës. Kjo është përgjegjësi e lartë, përgjegjësi që kërkon një shkallë të lartë të urtisë dhe të maturisë. Kuvendi dhe deputetët e tij do të jenë përgjegjës jo vetëm për interesat e elektoratit të tyre por për të ardhmen e tërë Kosovës në tërësi. Tani është në përgjegjësin tuaj që ta siguron vendosjen e një vetqeverisje efektive duke marrë përgjegjësi për një varg çështjesh që kanë të bëjnë me zhvillimin e Kosovës. Ju, gjithashtu do ta bartni përgjegjësinë për ta siguruar pajtimin ndëretnik dhe politik që të zëjë rrënjë fuqishëm në Kosovë dhe të gjitha komunitetet të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësit e barabarta, e largë nga çdo formë e diskriminimit. Vetëm kështu gratë dhe burrat e Kosovës mund të bëhen pjesë integrale e zhvillimit evropian dhe botërorë, bashkësia ndërkombëtare ka investu për të siguruar paqe 53 dhe stabilitet në Kosovë dhe në rajon në tërësi. Kjo do të jetë përgjegjësi e juaja e lartë, përpjekje për të siguruar kështu nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Të nderuar deputet të Kuvendit, sot është një ditë e veçantë jo vetëm për shkakun se ky Kuvend po fillon punën e tij të rëndësishme. Në këto çaste kur unë po flas, Sekretari i përgjithshëm Z. Kofi Anan gjendet në Oslo për të pranuar çmimin Nobel për paqe si shpërblim për përpjekje të pandalshme të Kombeve të Bashkuara për ta bërë botën tonë

ku jetojmë më paqësore dhe më të mirë.

Arritjet e mëdha gjatë atyre përpjekjeve të palodhshme që janë bërë këtu në Kosovë, që nga themelimi i UNMIK-u më 1999, Sekretari i përgjithshëm, laurati i çmimit Nobel z. Kofi Anan na ka lutur që t'ju përcjell juve një mesazh personal nga ana e tij. Kam nderin që t'iu përshëndes sot si përfaqësues të Kosovës të zgjedhur në mënyrë demokratike. Inaugurimi i Kuvendit tuaj shenon fillimin e paqes së pushtetit nga Kombet e Bashkuara tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes. Ky është një hap i rëndësishëm prej sendertimit të Rezolutës 1244. të Këshillit të Sigurimit të miratuar 30 muaj më parë.

Kjo është gjithashtu një gurthemel në rrugën drejt demokracisë dhe zhvillimit paqësor të Kosovës. Kjo është një ditë shprese, por është rast për të menduar dhe për ta ripërtritur vendosmërinë. Ju jeni të ballafaquar me sfidën e qeverisjes së përditshme efektive në rrethana veqanërisht të vështira, në të njejtën kohë, ju keni një detyrë të rëndësishme për ta tejkaluar trashëgimin e së kaluarës, dhe për ta vendosur një kulturë të tolerancës politike të respektit të ndërsjelltë dhe të kompromisit konstruktiv.

Askush nuk duhet të vuaj nga diskriminimi, për shkak të përkatësisë etnike të tij ose të saj. Së këndejmi, sigurisht se ky është një..... i mirë që krejt rastësisht ndodhi që Kuvendi juaj po inaugurohet të njejtën datë kur në botëshënohet dita e të drejtave të njeriut. Unë kam besim se ju do ta përdorni mandatin tuaj që u është dhënë nga populli i Kosovës, me menquri dhe ju dëshiroj shumë sukses në punën tuaj. Kofi Anan.

Të nderuar deputet të Kuvendit, Korniza kushtetuese parasheh që Kuvendi ta nxjerr rregulloren e vet të punës, me qëllim që Kuvendi të jetë në gjendje që të funksionoj deri atëher, unë kam nxjerrë një rregullore të përkohshme të punës, në mënyrë që rregullorja përfundimtare e punës të hyjë në fuqi sa më parë. Të formohet sa më parë një Komision mbi rregulloren e punës. Ky Komision pastaj do të propozojë Rregulloren përfundimtare të punës për miratim nga Kuvendi.

Më lejoni që tani të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, formimi i Kryesisë së Kuvendit siq parashihet në Kornizën kushtetuese. Unë do t'i lus përfaqësuesit që kanë të drejtë të propozojnë nga një ose më shumë anëtarë të kryesisë që ta bëjnë këtë, në bazë të Kornizës Kushtetuese. Subjekti politik që ka fituar numrin më të madh të votave në

zgjedhje për Kuvendin, ka të drejtë të propozojë 2 anëtarë të Kryesisë. Një anëtar i një subjekti politik do të jetë kryetar i Kuvendit.

Zonja dhe zotërinj, subjekti politik që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvendin është Lidhja Demokratike e Kosovës, së këndejmi lus Z. Rugova që t'i propozoj 2 anëtar të Kryesisë, si dhe njëkohësisht ta njoftoj Kuvendin se cili nga dy anëtarët e propozuar do të jetë kryetar i Kuvendit, urdhëroni Z. Rugova.

### **Dr. IBRAHIM RUGOVA**

I nderuari kryesues i mbledhjes inauguruese z. Hakerup, në emër të LDK-së kam nderin t'iu njoftoj se për Kryesinë e Kuvendit, janë emëruar këta 2 anëtarë, deputet, prof. Nexhat Daci, dhe dr. Fatmir Sejdiu. Prof. Nexhat Daci propozohet kryetar i Kuvendit të Kosovës, ju faleminderit.

### **Z. HANS HAKERUP**

Faleminderit shumë. Korniza kushtetuese i jep të drejtën subjektit politik që ka fituar numrin e dytë të votave që të propozojë dy anëtarë të Kryesisë. Zonja dhe zotërinjë subjekti politik që ka fituar numrin e dytë të votave në zgjedhjet për Kuvendin është Partia Demokratike e Kosovës PDK. Lusim z. Thaqi si bartës i listës së PDK-së që t'i propozojë dy anëtarë të Kryesisë, urdhëroni ju lutem.

### **Z. FATMIR LIMAJ,**

I nderuari z. Kryesues, të nderuar mysafirë dhe deputet. Më lejoni që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës t'iu përshëndes duke i uruar punë të mbarë Kuvendit. Pasi që Partia Demokratike e Kosovës dhe subjektet tjera politike kanë qenë në bisedë për të arritur një marrëveshje paraprake politike në mes të subjekteve politike shqiptare, Partia Demokratike tani për tani nuk i ka të gatshëm emrat për Kryesinë e Kuvendit. Shpresojmë se në një kohë të ardhme ne do ta kryejmë këtë detyrë. Gjithashtu më duhet të them në emër të Partisë Demokratike të Kosovës ne kemi kërkuar nga përfaqësuesit i zëvendëssekretari i Kombeve të

Bashkuara z. Hakerub, që në mesin e mysafirëve të ftohet edhe familja e cila është sinonim i lëvizjes së Kosovës familja Jashari.

### **Z. HANS HAKERUP,**

z. Hakerup. Z. Limaj duhet ti përmbaheni pikës së rendit të ditës. Mendoj se duhet ti përmbaheni pikës së rendit të ditës se është propozimi i kandidatëve për Kryesi, meqë PDK-ja nuk është e gatshme që ti propozojë anëtarët e vetë të Kryesisë, atyre u mbetet që t'ia paraqesin Kuvendit anëtarët e vet të Kryesisë në një fazë të mëvonshme. Kjo natyrisht nuk e pengon formimin e Kryesisë së Kuvendit, Korniza kushtetuese i jep të drejtën subjektit politik që ka fituar numrin e tretë më të madh të votave të zgjedhjeve për Kuvendin që ta propozojë një anëtar të Kryesisë. Zonja dhe zotërinj subjekti politik që ka fituar numrin e tretë më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvendin është Kualicioni Kthimi. Përveç kësaj, në bazë të Kornizës Kushtetuese një anëtar i Kryesisë duhet të caktohet nga radhët e deputetëve për Kuvendin që ju përkasin atyre parive që janë deklaruar si përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës. Subjekti i vetëm politik që është deklaruar si përfaqësues i komunitetit serb të Kosovës është kualicioni Kthimi. Lus z. Saviq si bartës i listës së Kualicionit Kthimi t'i propozoj dy anëtarë të Kryesisë.

### **G.GOJKO SAVIĆ**

Z. Saviq, e nderuara Kryesi, të nderuar deputet dhe kolegë, kuoalicioni kthimi është marr vesh që shefi i grupit të deputetëve të jetë Rada Trajković dhe lusim Rada Trajkovićin që ti propozoj dy anëtarë të Kryesisë.

(Është marrë nga përkthimi, e jo nga folsi, sepse nuk dëgjohet) Rada Trajković,

### **G.RADA TRAJKOVIĆ**

I nderuari përfaqësues i Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, para propozimit të dy përfaqësuesve të Kualicionit Kthimi kërkoj ndjes që anëtarët e kualicionit kthimi kanë hasur në vështirësi gjatë ardhjes këtu në Kuvend dhe dëshiroj të shprehë keqardhje se në mesin tonë nuk janë edhe përfaqësuesit e ..... të cilët me të vërtetë i kanë kontribuar më së shumti që deputetët serb edhe për shkallën e..... për

shkak të diskriminimit të jenë këtu. Deputetët tanë gjatë takimit me kryetarin Koshtunica dhe me përfaqësuesin e qeverisë z. Çoliq dhe z. Gjingjiq kanë marrë .  
(Është marrë nga përkthimi, e jo nga folsi, sepse nuk dëgjohej) Z. Hakerup.

**Z. HANS HAKERUP,**

Z. Trajković ju jeni këtu për ti propozuar dy anëtar të Kuvendit, ju lutem urdhëroni.

**Z.RADA TRAJKOVIĆ,**

Unë edhe njëherë dëshiroj të them se jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë dhe se së këndejmi unë do të propozojë dy kandidat tanë ky është Z. Gojko Saviq, dhe Z. Oliver Jovanović, dhe shpresoj që të gjithë së bashku vërtetë të ndërtojmë institucionet të cilat do të jenë në funksion të mirëqenjes të tërë njerëzve në këto hapësira.

(Është marrë nga përkthimi, e jo nga folsi, sepse nuk dëgjohej).

**Z. HANS HAKERUP,** faleminderit.

Në bazë të Komizës kushtetuese, kërkohet që një anëtarë i Kryesisë ..... të deputetëve të Kuvendit në bazë të këtyre partive që janë deklaruar si përfaqësues të komuniteteve jo shqiptare dhe jo serbe, deputetët në fjalë kanë vendosur që deputeti më i moshuar ndër ta z. Merxha, lus z. Merxha që ta propozoj një anëtar të Kryesisë.

**Z. MERXHA,**

Z. Kryesues dhe zotërinjë, në emër të grupit të pakicave kemi propozuar prej tre grupeve të kemi nga një kandidat, në të cilën do të jenë, ashtu faleminderit, për Kryesi do të emrohen nga një se smunden te tre me qenë por me short na ra neve egjiptasve, hashkalnjëive dhe romëve, të parët jemi ne, të dytët janë turqit të tretët janë Vatan. Edhe për atë prej turqëve do të jetë, hanëm efendi Nafije Gashi , nga vatani thanë qe biti

Gjezair Murati, prej partive egjiptase do të jetë më plaku unë Hagji Sylfi Merxha, falënderit.

### **Z.HANS HAKERUP,**

Të nderuar deputet të Kuvendit në bazë të Kornizës Kushtetuese, nga Kuvendi kërkohet që ti miratoi këto propozime me anë të votimit formal, prandaj unë do t'iu lus që të votoni me anë të ngritjes së dorës , .l.... të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit. Z. Nexhat Daci, Z. Fatmir Sejdiu, Z. Gojko Saviq, Z. Oliver Jovanoviq dhe Z. Zylfi Merxha dhe a jeni të gatshëm për të votuar, lua ata që janë për anëtarët e propozuar të Kryesisë së Kuvendit ju lutem ngriteni dorën tani. Dhe vazhdojmë ata që janë kundër ju lutem ngriteni dorën, Nëse ka apstenime ju lutem ngriteni dorën. Ju lutem do të vazhdojmë edhe njëherë ata që janë për ngriteni doren, falënderit ata që janë kundër, duhet që të votojmë përsëri ju lus ata që janë për ngriteni doren tani, tani ata që janë kundër ngriteni dorën dhe ju lutem a ka abstenime ata që nuk dëshirojnë të votojnë.

Rezultatet e votimit janë: 78 për , 3 jo dhe 2 abstenime.

Të nderuar deputet të Kuvendit, në bazë të rezultateve të votimit lista e propozuar e anëtarëve të Kryesisë u miratua formalisht, dhe pres që PDK-ja të dalë me propozimet e tyre më vonë për përfaqësuesit e tyre.

Më lejoni t'iu shpreh urimet e mia më të përzemërta anëtarëve të sapozgjedhur të Kryesisë dhe ju dëshiroj ç,do të mirë në punën e juaj të mëtutjeshme. Siq u cek më heret kryetar i Kuvendit do të jetë Z. Nexhat Daci, më lejoni të ftojë zotin Daci të zini vendin tuaj.

{shtë marrë nga përkthimi, e jo nga folsi, sepse nuk dëgjohet)

### **KRYETARI I KUVENDIT, Z. NEXHAT DACI,**

Z. Kelmendi: Unë besoj se duhet t'i përmbahemi rendit të ditës, dhe para se të jap fjalën përshëndetëse ju garantoj që do të jem shumë bashkëpunues me të gjithë ata që sot kanë qendrim abstenimi ose edhe kundër d.m.th. ju lutem që për hir të pranisë se tërë

opinionit ndërkombëtar dhe të gjitha mediave dhe për hirë të vetëvetes të procedurojmë me rendin e ditës që është marrë më heret. Faleminderit.

Unë besoj që egziston një rrugë parlamentare e shkëlqyshme, dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, duhet ta shfrytëzojë këtë mundësi dhe me shkrim të bëjë parashtrësë edhe për këtë kërkesë, por ju lutem procedurojmë me rendin e ditës.

### **KRYETARI I KUVENDIT, Z. NEXHAT DACI,**

Mysafirë të nderuar, z. Hakerup, zotëri të zyrave përfaqësues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkësisë Evropiane, Kanadasë, mysafirë të tjerë dhe ju kolegë deputet të respektuar. Në një datë dhe ditë historike për Kosovën si kjo e sotmja më duket që adresimi im më kuptimplotë parlamentit, popullit të Kosovës, diasporës kosovare, dhe opinionit ndërkombëtar, do të rezymohej në tri pyetje dhe në përgjigje të mundëshme në këtë kohë, hapsirë, e ato janë: ku gjendemi tani, kah jemi duke shkuar, dhe së fundi si do të arrijmë atje. Përgjigja shumë e shkurtër do të ishte tërësia është më tepër se shumica e pjesëve. Megjithatë zonja dhe zotërinj të më lejohet që të bëjë një përgjigje akademiko-politike për secilën pyetje në veçanti.

E para: Ku gjendemi tani, Kosova sot është vend i çliruar dhe me shumë sukses i mbrojtur nga forcat e NATO-s, si KFOR, dhe për këtë zoti gjeneral Valentë, juve personalisht dhe gjeneralëve paraardhës tuaj, z. Gjekson, Rajnard, Kabigjozo, dhe Skiaker i shkojnë falënderimet dhe mirënjohjet më të sinqerta të këtij Parlamenti të parit në Kosovën e çliruar.

Kosova sot, është vend i administruar nga administrata e Kombeve të Bashkuara nëpërmjet administratës ndërkombëtare të njohur si UNMIK dhe z. Hakerup përfaqësues special i z. Kofi Anan dhe udhëheqës suprem i UNMIK-ut bashkë me paraardhësin tuaj z. Kushner, pranoni falënderimet e sinqerta të këtij Parlamenti për punën e mundimshme, dobiprurëse dhe të suksesshme të udhëheqjes së Kosovës, dhe se bashkë me shumë



organizata joqeveritare dhe humanitare nga shumë vende të botës, me sukses tejkaluam periudhën emergjente dhe të rindërtimit gati të plotë të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj Kosova sot nëpërmjet përfaqësuesve të vet legjitim, të zgjedhur me votën e lirë të elektoratit të vet, vjen në këtë Parlament me pakon e ndishme dhe të dhimbshme të çështjeve pjesërisht të artikuluar, por jo edhe të definuara mirë dhe të zgjidhura e ato janë: Statusi i saj ndërkombëtarisht i pazgjidhur, çështja e invalidëve të luftës, pjesëmarrësve në çlirimin e Kosovës e atyre që gjymtyrët e veta ose pjesë të organeve vitale i dhuruan për lirin e Kosovës. Pengjeve të luftës, papunësisë më të madhe në regjion, situata tejet e rënd sociale, përfshirë pensionistët dhe të pastrehët, refugjatët e të gjithë popujve të Kosovës, që për arsye të mirënjohura lëshuan vendlindjen e tyre dhe emigruan në vende të largta apo në ato fqinje.

Pyetja e dytë kah jemi duke shkuar, më duket se në dy pyetjet e para përgjigjet janë më të lehta dhe më me shumë pika tangjente për shumicën absolute të anëtarëve të këtij Parlamenti. Kosova pas shumë shekujsh rrugëtimi të rëndë, ka përcaktuar definitivisht kahjen e rrugëtimin të mëtejshëm e ky është: Europa e bashkuar dhe integrimet veriatlantike, strategjia e këtij Parlamenti për të relizuar këtë orientim madhor do të jetë bashkëpunimi dhe kooperimi i ngushtë i këtij parlamenti me parlamentet e vendeve fqinje, me ato të gjithë Europës, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të gjithë botës. Metodologjia e kooperimit do të jetë ajo e dialogut të mirëfilltë për të gjitha problemet e hapura në regjion, e jo ajo e tensionimit dhe e krijimit të mjedisit tensionues,

Pyetja e tretë, si do të arrijmë atje, zonja dhe zotërinj, kolegë deputet të rrespektuar. Kosova ka një traditë parlamentare relativisht të shkurtër, më pak se një shekull, një traditë kryesisht të mirë, ngritje e vogël e vazhdueshme e statusit të sajë juridiko politik, por memorja e thjeshtë duhet të na përkujtojë edhe dy kuvendet më të dhimbshme të historikut të vetë parlamentarë, atë të Prizrenit të 8 dhe 10 korrikut të vitit 1945 dhe atë të Prishtinës 23 mars 1989. Zonja dhe zotërinjë deputet, strategjia e besueshme e realizimit të aspiratave kosovare, të shprehur në rezultatet e Referendumit të vitit 1991, dhe të luftës çlirimtare të viteve 1998 1999 është ajo që ky Parlament të krijojë infrastrukturë dhe mjedis të stabilitetit politik, ekonomik dhe sociokulturor. Stabiliteti politik do të realizohet me anën e krijimit të institucioneve të menagjimit të konflikteve, lirit etnike, civile dhe politike legalisht të garantuara .....sociale në mënyrë që ato të



mund të ruajnë stabilitetin makroekonomik, shoqërit me qarje të thella si kjo e jona përgjat vijave etnike ose të atyre regjionale, posaqërisht janë të predispozicionuara për paraliza të llojllojshme duke i bërë institucionet e menagjimit të konflikteve gjithnjë e më të rëndësishme në shoqërit e tilla.

Zonja dhe zotërinjë, duke përfunduar këtë adresim t'imin më lejoni të theksojë, që përbërja e këtij Parlamenti duhet të bëjë çdo gjë që është kompetenc e tij, që në tërë Kosovën e shenjtë të frymojë klimë që populli i saj shqiptar, serb, boshnjak, turk hashkalinj, romë egjiptas ta ndijnë atë për shtëpi të vetën, ndërsa paqen, tolerancën dhe fqinjësinë ta konsiderojmë si resurs të ecjes së Kosovës drejt integriteteve evropiane dhe veriatlantike.

Unë personalisht si kryetar i këtij Parlamenti do të jemë i gatshëm që me tërë kapacitetin tim krijues dhe veprues, ti shërbej synimeve të paraqitura në këtë bisedë inagurale, ndërsa kryesuesve të grupeve parlamentare u ofroj bashëpunim të sinqertë, do ta konsideroj veten të lumtur dhe të suksesshëm nëse arrij që gjatë mandatit tim të arrijë një të ashtuquajtur (jolitiiintersite) unitet në dallueshmëri, në Kosovë dhe krejt në fund nëqoftëse e kjo përbërje e Parlamentit nuk do të gjejë forcë morale dhe shpirtërore që të sendërtoj funksionin e vet historik, e që elektorati Kosovar me të drejtë e pret nga ne, atëherë le të bie mallkimi mbi ne. Ju faleminderit.

Koleg të nderuar deputet, meqë edhe fillimi ishte zgjatur, kaluan një orë e gjysmë më tepër se ora parlamentare dhe akademike, ju lutem për një pauzë 15 minuteshe për një kafe, ndërsa lus Kryesinë e posazgjedhur të Parlamentit që të ndalemi të takohemi këtu, Ju faleminderit

**Fillimi pas pauzës,**

**KRYETARI I KUVENDIT Z. NEXHAT DACI,**

Unë besoj që Kryesia në takimin e sajë të parë nuk e zgjati shumë, ishim të mendimit që pas kësaj periudhe që e kaluam në sallë të Parlamentit, pas rrjedhave punuese të parlamentit të bëjmë një ndërprerje të kësaj seance, pra nuk e konsiderojmë të

përmbyllur këtë takim të parlamentit, por bëjmë hapa të mëtejshëm që vërtet si një parlament i mirëfilltë që në takimin e ardhshëm që njëzërit e caktuam për të enjten, më 13 dhjetor në orën 11 të vazhdojmë me rendin e ditës që e ka çdo deputet, dhe të shpresojmë që atë ditë do të arrijmë ti kryejmë të gjitha pikat, dhe deri atëherë e njehta përbërje ndihmëse e sekretarisë do të na përcjell në punë të parlamentit, pastaj pas formimit të grupeve punuese të këshillave të punës ne do t'i çojmë punët ashtu siç mendojmë që është më së miri për Parlamentin .

## **Z. HASHIM THAQI,**

Unë nuk e besoj se është kryerje e rendit të ditës po qese i i pet fjala një deputeti të Kuvendit Kosovës, por edhe sa i përket shtyerjes së mbledhjes së Kuvendit do të duhej të ishim më konkret dhe më të argumentuar për arse se ne dëshirojmë të dijme se pse po shtyhet kjo mbledhje, mirëpo pasi që neve nuk na u dha fjala , si forcë e dyta politike që jemi në Kosovë për t'i shprehur mendimet tona në fillimin e punimeve të Kuvendit të Kosovës, atëherë ne deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës zhvilluam një konsultë që na erdhi si reagim ndaj udhëheqjes antidemokratike të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kosovës , nga një udhëheqje e cila mohoi të drejtën më elementare shprehjen e lirë të deputetit që është edhe një shkelje e imunitetit të deputetit të zgjedhur nga vota e lirë e qytetarëve, dhe mbasi që jemi sot në ditën e 10 dhjetorit, ditën e të drejtave të njeriut mund të them lirisht para jush, dhe qytetarëve të Kosovës dhe ndërkombëtarëve që janë këtu në sallë, z. Hans Hakerup është ai i cili bëri shkeljen më të rëndë të të drejtave të njeriut sot më 10 dhjetor në tër botën, sepse nuk iu lejua deputetëve që të , të lutem të lutem i ndëruar, tash u në do të flas, sepse nuk iu lejua asnjërit prej deputetëve që të shprehin mendimin e vet. Ne kemi diskutuar gjërë e gjatë që të arrijmë një marrëveshje në mes spektrit politik shqiptarë dhe joshqiptar dhe ato diskutime kanë qenë .....ndërpritet diskutimi për momentin.

**Nderhyrje në fjalën e deputetit Hashim Thaqi,  
KRYETARI I KUVENDIT,Z. NEXHAT DACI,**

Z. deputet ju lutem nuk është, nuk mund të shërbehet kjo platformë për akuzat ndaj përfaqësuesit të sekretarit special .

**Nderhyrje në fjalën e deputetit Hashim Thaqi,**

**Z. DACI,**

Unë e shpalla të përfunduar Parlamentin dhe nuk është e mirë të shfrytëzohet foltorja që ti adresohemi me kritika Kombeve të Bashkuara dhe sekretarit, ju lutem zoti deputet.

**FILLIMI I SEANCËS SË KUVENDIT,  
E NDËRPRERË MË DATËN 10.12.2001,  
E FILLUAR MË DATËN 13.12.2001**

## **KRYETARI I KUVENDIT, Z. NEXHAT DACI,**

Zonja dhe zotërinjë, deputet të nderuar të shpresoj që gjatë zgjatjes së mandatit tim do të jetë hera e parë që do të fillojë me vonesë prej 10 minutash.

Dhe më lejoni që ti vazhdojmë punimet e seancës të filluar më 10 dhjetor ditën e hënë Rendi i ditës është i njejtë, ai që e kemi marrë, prandaj, për të mos humbur kohë, ftoj përfaqësuesin ose kryesuesin e grupit parlamentar të grupit që ka numrin e dytë të ulëseve në Parlament, të nominoj nëse kanë marrë qëndrim për dy anëtarë për Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, urdhëroni deputet të Partisë Demokratike të Kosovës.

## **Z. JAKUP KRASNIQI,**

Të nderuar delegat, zonja dhe zotërinjë, Partia Demokratike e Kosovës, ende nuk i ka të gatshëm kandidatët për Kryesinë e Parlamentit dhe mendoj që me krijimin e kushteve, Partia Demokratike do të nominojë kandidatët e saj në Kryesinë e këtij Parlamenti, ju faleminderit.

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Ju faleminderit z. Krasniqi, atëherë fillojmë me pikën e rendit të ditës, zgjedhjen e kryetarit të Kosovës. Z. Daci, vetëm një skjarim më duhet në fillim tu jap se në ndërkohë dua t'iu informoj se në emër të Kuvendit të Kosovës dhe të z. Nexhat Daci besoj që më kanë emëruar si deputet, ka mbërritur një kërkesë e grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas konsultimeve dhe mendimeve, unë kam dëshirë të tregojë gatishmërinë e këtij Parlamenti për të dëgjuar kërkesat e grupeve parlamentare dhe ma së miri vetë z. Kelmendi t'i artikulon kërkesat e tyre.

## **Z. MUHAMET KELMENDI,**

Të nderuar zonja dhe zotërinjë, deputet të dashur, pas seancës së parë grupi parlamentar i Aleancës për ardhmërinë e Kosovës, e mbajti mbledhjen e parë dhe e ka shkruar një

letër të cilën ia ka drejtuar Kuvendit të Kosovës dhe personalisht Z. Nexhat Daci, e nënshkruar është nga ana ime si udhëheqës i grupit parlamentar, për të mos shkruar këtu që ti shprehi mendimet e tjera unë dua ta lexoj letren në mënyrë që të kuptohet, se çka qëndron në të, sepse nga letra e shkruar na dalin edhe rendi i ditës për ditën e sotme për të cilën paraprakisht po them se jemi të mendimit, për shkak të gjendjes së krijuar mos krijimit të rednit të punës paraprakisht, mosarritjes së marrëveshjes për rendin e tillë të punës, rendi i ditës të pësojë ndryshime dhe të ketë vetëm dy çështje, e para, plotësimi i mëtejshëm i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe e dyta: zgjedhja e një komisioni i cili do të merrej me përgatitjen e Rregullores për punën e Kuvendit të Kosovës në bazë të së cilës do të procedurojmë në mbledhjet e ardhshme

Z. Daci, seanca e Kuvendit të Kosovës e mbajtur më 10 dhjetor 2001 ishte ishte në nivelin që ne si grup parlamentar e kemi dëshiruar. Grupi parlamentar i AAK-së ka pritur që kjo seancë të ketë karakter festiv dhe solemn, por nuk ndoshi kështu. Procedura e ndjekur në seancë ishte shkelje e të gjitha rregullave demokratike. Grupi parlamentar i AAK-së konstaton:

1. Se zgjedhja e Kryesisë dhe e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ka qenë në kundërshtim me rregullat demokratike, sepse grupit parlamentar të AAK-së nuk iu dha e drejta për t'i paraqitur idet dhe propozimet e veta për mirëvajtjen e punës së Kuvendit. Zgjedhja e juaj u bë vetëm me votat e LDK-së, të disa votave të pakicave, të koalicionit serb. Povratak heq dorë nga pozita juaj që keni dalur sot.
2. Grupi parlamentar i AAK-së kërkon që të veprohet sipas propozimeve të paraqitura në seancë që në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës të pranohen dy deputet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës,
3. Në sallën e Kuvendit të Kosovës, megjithëse kjo e keqe është realizuar, por unë po e lexoj megjithatë, në sallën e Kuvendit të Kosovës të bëhet riorganizimi i ulëseve për anëtarët e grupit tanë. Ne kërkojmë që të ulemi në shtyllën A të ulëseve të Kuvendit të Kosovës, ana e majtë nga presidiumi i Kuvendit.
4. Në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës, të mos parashihet asnjë rend tjetër pune, pos konstituimit të mëtejshëm të Kuvendit, sepse pa te nuk ka mundësi të vazhdohet me pika të tjera.

5. Pa zgjedhjen e grupit punues për hartimin e Rregullores së punës së Kuvendit është e pamundëshme të eliminohen parregullsitë dhe të vazhdohet me seanca të tjera në Kuvend. Kërkojmë që çështjet e shtruara më lartë të hasin në mirëkuptim, mundemi që paraprakisht ti diskutojmë dhe ti parashtrojmë dhe ti mbrojmë në seancën e ardhshme të Kosovës. Pra, kërkesa jonë përfundimtare është që sot t'i kemi dypikatur rendit të punës: E para, plotësimi i mëtejshëm i Kryesisë së Kuvendit, dhe së dyti: zgjedhja e Komisionit që do ta hartonte Projektin e Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, sepse ne me rregulloren e këtillë të cilën na ka ofruar, të cilën nuk e njohim në tërësi, se njohim fare, se se kemi pasur, përveç në mbledhje kur kemi marrur pjesë dhe e kemi kundërshtuar nuk kemi rregullore tjetër dhe nuk e dijmë procedurën e mëtejshme, ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, Z. NEXHAT DACI,**

Faleminderit z. Kelmendi. Për informim kërkesa është dorëzuar në procedur normale parlamentare ajo që ishte kompetenc e Kryesisë shihet ..... sot, pjesa tjetër do të jetë pjesë e punës së Parlamentit., Unë i spiegova edhe në grupin parlamentar që ne sot të vazhdojmë me të njëjtin rend pune, andaj ftoj udhëheqësin e grupin parlamentar të grupit politik që ka nummrin më të madh të ulëseve në këtë parlament, prof. Sabri Hamitin, që të bëjë ose dikush tjetër sa po e shof Nekibe Kelmendin që të bëjë propozimin e atij grupi politik për kandidatin për kryetar të Kosovës, urdhëroni z. Nekibe.

**Z. NEKIBE KELMENDI,**

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputet. Në bazë të dispozitave të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme të Kosovës, dhe të rregullave të rregullores së përkohshme për punën e Kuvendit të Kosovës, shfrytëzoj të drejtën dhe kam nderin që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës të propozojë për kryetar të Kosovës dr. Ibrahim Rugovën, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Që nga viti 1989 dhe bartës i listës së deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ibrahim Rugova u lind

më 2 dhjetor 1944 në fshatin Xërxë, Komuna e Istogut, Kosovë, Shkollimin e mesëm e kreu në Pejë. Më 1967. Diplomoi në fakultetin e filozofisë të Universitetit të Prishtinës më 1971. Ibrahim Rugova doktoroi në Universitetin e Prishtinës në vitin 1984. Është anëtarë korrespondent i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Kosovës. Dr. Ibrahim Rugova është laureat i shumë çmimeve ndërkombëtare, i çmimit për paqe të Fondacionit Paulicek të Danimarkes, doktor nderi honoris causa, i Universitetit të Parisit 8 Serbon Francë i çmimit Saharov i Parlamentit Evropian, i çmimit për paqe të qytetit Minster në Gjermani, dhe i çmimit për paqe të Unionit Demokratik të Katalonisë, Manuel Karasko Forminguera në Barcelonë Spanjë, Prishtinë 13 dhjetor 2001, Lidhja Demokratike e Kosovës, ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Zonja Kelmendi ju faleminderit. Si ipas Kornizës Kushtetuese të drejtë kandidimi për kryetar të Kosovës ka grupi parlamentar, ose bashkimi i grupeve parlamentare që kanë së paku 25 ulëse në këtë Parlament, prandaj me që Partija Demokratike e Kosovës edhe vet e plotëson këtë kriter, pyes Partin Demokratike të Kosovës, përfaqësuesit e saj a dojnë të nominojnë ndonjë kandidat për kryetar të Kosovës, dhe përfaqësuesi le të urdhërojë ta marrë fjalën, ju lutem.

### **Z. JAKUP KRASNIQI,**

Të nderuar zonja dhe zotërinjë, më lejoni që në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, t'i shpreh disa qëndrime të cilat mendojmë se e nderojnë jo vetëm të vërtetën mbi demokracinë e sapofilluar institucionale të Kosovës të cilën gjithë së bashku do të përpiqemi ta ndërtojmë, por edhe vetë vendin e parë demokratik Kosovës në të cilin besojmë se kanë zënë vende deputetët të cilët do të kenë pa dyshim një rol historik për ardhmërinë e Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Pa dallime fetare, etnike dhe politike. Tashma të gjithë e kemi në vete kujtimin e mbledhjes së parë të këtij Kuvendi dhe me të drejtë secili do ta gjykojë nga këndvështrimi i vet, apo edhe i



subjektit politik ku ban pjesë. Kjo është një dhunti, një fat dhe një fryt i demokracisë çka do të thotë se edhe mospajtimet janë pjesë e rregullave të demokracisë.

Meqenëse është folur dhe komentuar shumë për mbledhjen e parë të Kuvendit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës ka kënaqësinë e vet që edhe njëherë të shprehë hapur qëndrimin e saj qendror se ne kemi qenë dhe do të jemi për bashkëqeverisje të spektrit të gjërë politik në Kosovë duke i përfshirë brenda sajë edhe komunitetet e etnive tjera sepse, vendi ynë ndodhet para ndërtimit të dy procesve fundamentale të shoqërisë kosovare, të cilat sipas Partisë Demokratike të Kosovës janë: procesi i demokracisë dhe procesi i ndërtimit të institucioneve demokratike shtetërore.

Meqenëse këto procese janë të ndërlidhura dhe të kushtëzuara në mes veti, partija Demokratike e Kosovës e vënë në dispozicion gjithë potencialin e sajë kadrovik, dhe demokratik, moral dhe intelektual, profesional e politik në shërbim të ndërtimit të këtyre proceseve në bashkëqeverisje me subjekte të tjera politike të këtij Kuvendi, duke qenë e gatshme që të merrë detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e tyre të plotë. Sepse për çështje të tjera fundamentale na obligon e kaluara e largët dhe e afërt, lufta çlirimtare gjaku i dëshmorëve, sakrificat e popullit të Kosovës, ndihma e pakursyer e shteteve euroatlantike me në krye shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian

Sepse për çështje të tilla madhore na obligon ardhmëria demokratike e Kosovës e cila duhet të ndërtohet; për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallime fetare etnike dhe politike ku siguria, paqja duhet të vlejë për çdo qytetar të Kosovës, ku do të garantohet siguria e plotë e qarkullimit të njerëzve të mallërave dhe të ideve. Duke i peshuar në përgjithësi këto qaste historike për ardhmërinë e vendit tonë Partia Demokratike e Kosovës shpreh edhe njëherë gadishmërinë e saj për të bashkëqeverisur seriozisht dhe sinqerisht me partinë që ka fituar numrin më të madh të votave në Parlamentin e Kosovës, si dhe me partitë e tjera të këtij Kuvendi. Partia Demokratike e Kosovës, e sheh formimin e një Qeverie në baza të gjëra të spektrit politik, sepse sa më stabile dhe më e qëndrueshme që të jetë ajo, aq më e suksesshme do të jetë edhe puna e saj në rrugën e ndërtimit të demokracisë dhe të institucioneve të shtetit të Kosovës.

Në këtë bashkëqeverisje Partia Demokratike e Kosovës i fton të gjithë subjektet politike të etnive dhe të grupacioneve tjera etnike dhe është dhe jemi të bindur se një bashkëqeverisje e spektrit të gjërë nuk e dëmton anjë subjekt politik dhe asnjë grupacion

etnik, dhe do të ishte një nderim në nderin dhe detyrën e çdo parlamenti të Parlamentit të Kosovës që lirinë, paqen dhe demokracinë dhe pavarësinë të mos e mbaj peng as për veti as për fëmijët e tyre. Ne ftojme të gjithë delegatët e Kuvendit të Kosovës që ta bëjnë një fillim të mbarë se është koha vërtet për të menduar kthjellë për perspektivën tonë dhe perspektivën e fëmijëve tanë. Partija Demokratike e Kosovës, konsideron se nuk janë krijuar kushtet që ajo të del para këtij Kuvendi me propozimin e saj, dhe Partija Demokratike e Kosovës i njofton të gjithë delegatët që nuk do të marrë pjesë në votimin e sotëm, ju falënderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**, z. Krasniqi ju falënderit, për këtë kontribut

Mirë pra, vazhdojmë me punën e rregullt, me që kemi vetëm një kandidat, më falni urdhëroni z. Trajković.

**Z.RADA TRAJKOVIĆ,**

Poštovani predsedavajući, poštovani kolege poslanici, želim da vas obavestim da poslanički klub kvalicije Povratak naravno da nema svog kandidata, a sigurno neće podržati kandidata nijednog sobzirom da partije koje su imale mogućnost da imaju svoje kandidate, zaista nisu našle ni jedan put zashodno da napravve makar dogovore, konsultaciju, sa srpskom kvalicijom Pivratajm da izaberemo čoveka u koga ćemo svi zajedno i mati poverenje i koji će zaista podruditi za perspektivi sa svima nama koji sedemo na ovom Parlamentu i svima onima koji su nas izabrali da budemo u ovom Parlamentu omogući jednak i prosperitetan život na ovom prostoru, stim u vezi želim javno da kažem postojuci instituciji Skupštine Kosova i postojuci izborni proces kvalicija Povratak uzeće svoje glasačke lističe i piči ču procesu glasanja ali sigurno neće glasati, fala.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**, faleminderit,

Unë mendoj se duhet të vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, unë e kam broshurën, të gjithë e kemi, grupi parlamentar, urdhëroni z. Haxhi.

### **Z. Haxhi ZYLFI MERXHA**

Zonja dhe zotërinjë, deputet të nderuar, tu i ndëgjua diskutimet e partive të mëdha tri partive kisha lut në emër të juajin dhe në emër të popullit të Kosovës, të zgjasim dorën njëri tjetrit, sepse populli që na ka zgjedhë të ketë besim në ne dhe ne si anëtarë të Parlamentit t'i kryejmë detyrat e tona që na kanë besuar, kështu nuk na ka hije, në qoftë se anjë parti tjetër nuk po merr vendin e vet si do të bëhet me një parti. I ndëgjua dy partit e mëdha e ndëgjua edhe z. Trajković çka tha po çka jemi duke bërë ne këtu, unë nuk po di se ku po na çon kjo rrugë por ju kisha lut më së pari dy partive të mëdha le tja zgjasin dorën njëri tjetrit edhe ne të gëzohemi delegatët e këtij Parlamenti edhe ta bijmë një vendim të shëndoshë për të gjithë popullin e Kosovës që jeton këtu, Ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Kam një lutje nga shërbimet teknike që telefonat celular ju lutem të shkyçen sepse ka interferencë të keqe në transmetime, ju faleminderit.

Unë po vazhdoj me leximin e emrave të deputetëve të cilën listë unë posedoj këtu, më falni urdhëro.

### **Z. MAHIR JAKXHILLAR,**

Mahir Yağcılar.Kosova Türk Demokratik Pratisinden geliyorum.İlk önce Kosova Meclisini tebrik etmek istiyorum.Tüm milletvekillere başarılar diliyorum.Ama şu anda gerçekten zor bir durumdayız. Kosova başkanı seçilecek ama Kosova başkanı tüm Kosova nın başkanı olması gerekiyor. Ve biz bu konuda her zaman Kosova nın başkanı olacağını destekliyoruz. Onun için bu konuda ilk önce üç büyük Arnavut partisinin arasında anlaşıp en iyi bir biçimde bizlere de bir yol göstermelerini istiyorum. Şu anda gerçekten biz zor bir durumdayız. Ama iki büyük parti diğer bir toplum işte başka bir toplum yoksa o zaman biz de zor duruma geliyoruz ve bizden bir öneri geliyor mesela

Meclis başkanı şu anda bütün partilerin gruplarını toplayarak bir araya bu çözümü bir an önce çözelim yoksa yalnız oylamaya giderse o zaman Kosova kaybedecektir o zaman hepimiz kaybedeceğiz en iyidir sanırım öneri olarak Meclis başkanı yeni parti temsilcilerini bir araya toplayıp bu sorunu çözsünler. Bu konuda bir partiye bizim tek desteğimiz olamaz ancak ve ancak bütün Arnavut partileri aralarında anlaşsın o zaman bizden de destek olacaktır. Teşekkür ediyorum.

## **Z. XHEVDET NEZIRAJ**

I nderuari kryetar i posazgjedhur, të nderuar deputet të Kosovës dhe të Parlamentit të Kosovës, unë quhem Xhevdet Neziraj, anëtar i Partisë Inisiativës së Re Demokratike të Kosovës dhe përfaqësohem me dy kandidat, prandaj vota Inisiativës së Re Demokratike të Kosovës, do të jetë votë për Kosovën do të jetë votë për të ardhmen e saj për qytetarët e saj që mezi presin konstituimin e Kryesisë së Kuvendit dhe zgjedhjen e kryetarit që të na shtyjë në një zhvillim ekonomik dhe në një prosperitet. Dua ta tërëjki vërejtjen e parë në lidhje me zgjedhjen e z. Zylfaj si kryetar i komunitetit, ne atë ditë u paraqitëm kërkesën që është person më i vjetër dhe vetëm ditën e parë të na përfaqëson ndërsa ditët tjera të gjejmë zgjidhje, ndërsa ai atë ditë u paraqit në emër të grupit dhe e shpalli veten si kryesues, që do të thotë se nuk pajtohemi, dhe ate qitash do ta qesim me shpresë, pranë sekretariatit, ndërsa në zgjedhjen e kryetarit kishte me qen shumë më mirë që të ketë pëlqim të të gjitha partive dhe subjekteve politike për një ardhmëri më të mirë të Kosovës, ju falënderit.

**Z.SABIT RRAHMONI**, Ju falënderit z. Kryesues,

Të nderuar zonja dhe zotërinjë, deputet të nderuar, jamë Sabit Rrahmani nga partia Demokratike Hashkalinjëve Shqiptarë të Kosovës, që përfaqësohem me dy kandidat. Së pari dëshiroj të shtojë që këtu në Parlamendin e Kosovës të mos ketë një lojë të subjekteve politike të Kosovës, por të jetë një lojë e bashkqeverisjes për të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët e pranojnë realitetin e ri në Kosovë. Ne edhe gjatë fushatës elektorale pothuaj se të gjithë liderët politik kanë theksuar se do të bashkqeverisin

ndërmjetveti, dhe unë si anëtarë i Partisë Demokratike të Hashkalinjëve Shqiptarë të Kosovës dhe të komunitetit hashkalinj kërkoj që sot mos të bëhet votimi për kryetar të Kosovës por të mirret një pauzë prej 2, 3 orë nëqoftëse ka nevojë një ditë një javë në mënyrë që edhe njëherë të takohen tre liderët e partive më të mëdha politike dhe të vendoset një ardhmëri për të gjithë kosovarët të cilët e pranojnë realitetin e ri në Kosovë, shtetin e Kosovës dhe bashkëqeverisjen e institucioneve të Kosovës në përgjithësi të të gjithë kosovarëve e jo të subjekteve politike të Kosovës, Ju falënderit.

### **G.NOMAN BALIĆ,**

Dëshiroj të përshëndesë edhe ata që gjenden në Kryesi dhe kolegët e mi të cilët gjendemi në një pozicion shumë të palakmueshëm dhe delikat me sjelljen e disa partive politike, që ne duhet të gjejmë një rrugdalje nga kjo gjendje. Unë normalisht besoj që Vatani dhe në emër të boshnjakëve dhe goranëve që unë përfaqësoj që duhet të jemi të kuptimtë që në këtë pozicion të krijuar njëfarë polarizimi që të votohet apo të mos votohet dhe ne gjendemi në një pozitë që të votohet për një parti politike ndërsa dy partit e mëdha tjera të mos votojnë, poashtu edhe serebët të mos votojnë, kurse partitë e tjera më të vogla janë të pavendosur por unë sa e kuptoj nuk do të votojnë fare. Kjo është një matematik e thjeshtë dhe ne duhet të kemi mirëkuptim në qëndrimet e të gjithëve që folën deri më tani ..... tash unë do tju flasë për qëndrimin tim personal të cilin e kam parashtruar dje dhe sot dhe unë shtoj se jamë në marrëdhënie të mirë me partit shqiptare dhe i të gjithë partive tjera, dhe mendimi im është të votojmë dhe duhet të votojmë dhe me anë të votimit të shohim si të votojmë, dhe pas tërë kësaj që dëgjova kjo nuk ka qenë me interes shumë e se vetëm një parti politike është për atë, kurse të tjerat janë për jo dhe të tjerat ende nuk dijnë si të veprojnë, prandaj është e nevojshme që të kemi marrëveshje në mes nesh dhe në fund të fundit kryesuesi tha që të marrë vendim por qëndrimi ynë është që ..... megjithatë duhet të arrijmë një marrëveshje, falënderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Para se të marrë një qëndrim të caktuar, më lejoni që t'iu lexoj listën e deputetëve në Parlamentin e Kosovës. I kisha lutë përfaqësuesit të Partisë Demokratike që e kishte fjalën të gjitha grupacionet politike e muarën fjalën më lejoni vetëm ta lexoj e pastaj shofim .

Nga LDK-ja listës së grupit parlamentar, grupit më të madh në parlament i prinë dr. Ibrahim Rugova, Kolë Berisha, Nekibe Kelmendi, Nexhat Daci, Sabri Hamiti, Edi Shukriu, Fatmir Sejdiu, Naim Jerliu, Fetie Këpuska, Behxhet Brajshori, Imer Muhagjeri Sanije Alijaj, Fadil Geci, Edita Tahiri, Fadil Kryeziu, Alush Gashi, Melihate Tërmkolli, Fatmir Rexhepi, Niman Alimusaj, Sofije Harxhi, Agim Krasniqi, Ramadan Kelmendi, Nafije Berisha, Ali Sadriu, Haki Shatri, Sanije Zeqiraj, Ibush Jonuzi, Sadudin Berisha, Remzije Nimani, Lulzim Zeneli, Mevlude Saraqi, Jusuf Suta, Gani Prekopucaj, Gylqen Berisha, Smajl Hajdaraj, Besa Gaxheri, Ilmi Ahmeti, Tomë Hajdaraj, Mehmet Neziri, Zyhrije Maloku, Halil Ahmeti, Sabit Rustemi, Nurishahe Hulaj, Esat Dauti, Blerim Baruti, Sahit Krasniqi, Ilaz Pireva.

Listës së Partisë Demokratike të Kosovës: GRUPACIONIT POLITIK që ka numrin e dytë të ulëseve në Parlament i prinë: Hashim Thaqi, Arsim Bajrami, Flora Brovina , Hajredin Kuqi, Jakup Krasniqi, Drita Statovci, Fatmir Limaj, Ali Jakupi, Teutë Hadri, Bajram Rexhepi, Ismajl Kurteshi, Nergjivane Dauti, Sejdullah Hoxha, Bajrush Xhemajli, Sala Ahmetaj, Hydajet Hyseni, Shefki Sejdiu, Egjlale Salihu, Emin Krasniqi, Gjavit Haliti, Hatigje Hoxha, Berat Luzha, Gani Koci, Sabile Basha, Lirak Çelaj dhe Driton Lajqi, Bashkimit Kthimi i prinë Gojko Saviq, Goran Llazoviq, Smilka Milisavleviq, Momqillo Saviq, Nenad Radosavleviq, Liljana Keniq, Petar Radosavleviq, Rada Trajkoviq, Millovan Jovanoviq, Stojanka Petkoviq, Sokol Gjorgjeviq, Bogoljub Millosheviq, Sllobodan Bjelliq, Oliver Jovanoviq, Sveta Vujaqiq, Rangjell Nojkiq, Dejan Mitiq, Ivana Markoviq, Svetomir Samargjiq, Ljubomir Stanajkoviq, Vesna Jovanoviq, dhe Dragisha Kërstoviq.

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i prinë Ramush Haradinaj, Bajram Kosumi, Zylfije Hundozi, Muhamet Kelmendi, Bujar Dugolli, Sebahate Krasniqi - Grajqevci, Naim Maloku dhe Mahmut Bakalli,

Kualicionit Vatan i prinë, Zehra Elezi, Gjezair Murati, Rrustem Ibishi dhe Numan Baliq,

KDTP, Mahir Jakgjillar, Gani Sadik, Nafije Gash.

IRDK, Bislim Hoti, Xhevdet Neziraj.

PDASHK, Sabit Rrahmani, Faik Marolli.

BDSAK, Hilmo Kandiç,

LKÇK, Istref Kelmendi,

LPK, Bedrush Qollaku,

PD, Sylejman Qerkezi,

PREPK, Zylfi Merxha,

PSHDK, Mark Krasniqi,

I dëgjuat emrat e të gjithë deputetëve. Një pauz 15 minutëshe, urdhëroni edhe një fjalë të fundit edhe .

#### **Z. ISTREF KLINAKU,**

I përshëndes të gjithë deputetët, dola këtu për të bërë vetëm një thirrje që është mirë të jemi korrekt dhe të përpiqemi që në të gjitha çështjet të jemi korrekt. Për këtë arsye unë bëj një vërejtje te kryetari i Kuvendit, ka deklaruar në media që në Parlamentin e Kosovës janë të përfaqësuara të gjitha forcat politike që përkrahin pavarësinë e Kosovës, gjë që nuk është e saktë. E dyta këtu nuk lexohet drejt emri dhe del që në këtë Parlament është Istref Kelmendi që është një njeri sedita keni përvojë për këtë punë, e treta une propozojë që të shkohet me rend të ditës, dhe të mos i iket rendit të ditës për shkak se kemi ardhë në një situatë që një forcë politike që ka propozu kryetarin



d.m.th do të dështojë skemi pse të procedojmë dhe votojmë ashtu qysh është në rend të ditës, Istref Klinaku LKQK, faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Pauzë 15 minuta ju lutem.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Kolegë deputet duhet t'iu komunikoj rezultatet e punës që kemi bërë deri më tash, gjegjësisht të procesit të votimit, ato janë: të pranishëm në seancë 118 deputet, pjesëmarrës në votime 70 kuorumi i nevojshëm 61 shumica e nevojshme 80 nga ata deputet që kanë votuar për kandidatin e propozuar për kryetar të Kosovës 49 deputet kanë votuar për ndërsa të pavlefshme në aspektin teknik janë 21 vota prandaj unë propozoj që të ndërpritet seanca, vazhdimin e saj deputet të nderuar do ta konfirmojmë dhe do ta merrni me shkrim vazhdimin e seancës, ju falënderit për pjesëmarrje dhe për kontribute, dhe të gjithë atyre që kanë festat në fund të vikendit ju uroj festë, punë të mbarë dhe shëndet.